



LIRITË E INTERNETIT

Përmbledhje



IMPRINT

Botuar nga:
Civil Rights Defenders

Për botuesin:
Goran Miletic

Autorët:
Fondacioni SHARE

Andrej Petrovski
Bojan Perkov
Kristina Cendic
Filip Milosevic

Redaktorët
Neda Mirkovic
Philip Merrell

Punimi grafik:
Marko Kovachevski

LIRITË E INTERNETIT NË RAJONIN E BALLKANIT PËRËNDIMOR

Përmbledhje

PARATHËNIE

Qeveritë në Ballkanin Perëndimor kanë rrezikuar vazhdimisht të drejtën e lirisë së shprehjes duke mbyllur faqet e mediave, faqet e lëvizjeve shoqërore dhe duke frikësuar aktivistët individualë në internet. Për më tepër, ekziston një tendencë në rritje e miratimit të legjislacionit që synon censurimin e përmbajtjes në internet. Ekzistojnë gjithashtu shqetësime në rritje për sa i përket mbikëqyrjes dhe mungesës së mbrojtjes efikase të të dhënave personale të qytetarëve. Masat e tilla kufizojnë dhe kufizojnë pjesëmarrjen qytetare dhe minojnë vetë themelin e demokracisë.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rekomandimet e bëra nga Këshilli i Evropës theksojnë se vendet anëtare janë përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe standardeve themelore të lirisë në lidhje me internetin. Përveç kësaj, shtetet anëtare kanë një detyrim ndaj qytetarëve të tyre që të respektojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në internet.

Civil Rights Defenders në bashkëpunim me fondacionin SHARE realizuan një studim mbi gjendjen e lirisë të internetit në Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Ky raport ofron një përmbledhje krahasuese të treguesve specifikë dhe zhvillon një seri rekomandimesh për qeveritë e këtyre vendeve për të përmirësuar gjendjen e lirisë të qytetarëve në internet.

Treguesit e studimit u bazuan në treguesit e lirisë së internetit të përfshira në Rekomandimin e Këshillit të Evropës CM / Rec (2016) 5 për Lirinë e Internetit dhe janë përshtatur në përputhje me kontekstin vendor. Ata posaçërisht përfshijnë 4 fusha kryesore: (1) një mjedis mundësues për lirinë e internetit, (2) të drejtën e lirisë së shprehjes, (3) të drejtën për lirinë e tubimit dhe organizimit dhe (4) të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Secili grup treguesish siguron një pasqyrë më të thellë në fushën e përcaktuar nëpërmjet nën-treguesve, të cilët ndryshojnë në numër në varësi të kompleksitetit të temës.

Një studim i tillë është i nevojshëm për të identifikuar zonat më problematike në secilin vend dhe në të njëjtën kohë për të analizuar rreziqet që janë të zakonshme për qytetarët në të gjithë rajonin. Kjo qasje gjithëpërfshirëse është thelbësore për të siguruar që rekomandimet janë praktikisht të zbatueshme dhe me rëndësi kritike për të ardhmen e lirisë të internetit në Ballkanin Perëndimor.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në internet është e garantuar me ligj, në përputhje të plotë me nenet përkatës në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Çdo organ shtetëror që ka kompetenca rregulluese apo kompetenca të tjera në çështjet e internetit, e kryen veprimtarinë e tij i pandikuar nga ndërhyrje politike apo tregtare, në mënyrë transparente dhe duke mbrojtur e promovuar lirinë e internetit.

1. NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR LIRINË E INTERNETIT

Kornizat ligjore të vendeve të përfshira në raport kryesisht mundësojnë lirinë e medias dhe internetit, disa vende e kanë dekriminalizuar shpifjen dhe kanë miratuar ligje të reja për sigurinë kibernetike. Por, përkundër këtyre dispozitave, zbatimi i ligjeve mbetet i diskutueshëm. Arsyet e zbatimit problematik qëndrojnë kryesisht në mosmarrëveshjet dhe presionet politike, si dhe në disa raste për shkak të trashëgimisë nga vitet '90.

- ▶ Në Bosnje dhe Hercegovinë, shumica e kornizës ligjore është përshtatur nga komuniteti ndërkombëtar pas luftës. Sidoqoftë, ndarjet e forta përgjatë vijave etnike pengojnë zbatimin e saj dhe shkaktojnë pengesa në miratimin e ligjeve të reja dhe përafrimit të ligjeve ekzistuese me standardet ndërkombëtare në lidhje me sigurinë kibernetike. Ligji për Paqen dhe Rendin Publik nuk e përcaktoi përkufizimin e një hapësire publike dhe shkaktoi një efekt frikësues duke përfshirë internetin dhe median sociale në zbatimin e tij.
- ▶ Ndryshimet në kornizën ligjore në lidhje me median në Shqipëri parashikuan regjistrimin e mediave online dhe policimin e përmbajtjeve të lajmeve, me gjopa potencialisht shumë të mëdha dhe gjithashtu me mbylljen e mundshme të faqeve të internetit.
- ▶ Sipas Strategjisë për Luftimin e Krimin Kibernetik nga viti 2019 deri në vitin 2023, Serbia ende duhet të harmonizojë kornizën ligjore kombëtare me Direktivën e BE-së për sulmet kundër sistemeve informative.
- ▶ Në dallim nga tre vendet e tjera, Kosova nuk është palë nënshkruese e Konventës së Budapestit për Krimin Kibernetik, dhe megjithëse Kosova ka Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimin Kibernetik, është Kodi i Procedurës Penale ai që prevalon nëse ka mospërputhje midis dy këtyre ligjeve .



2. E DREJTA E LIRISË SË SHPREHJES

Liria për të patur akses në internet dhe neutraliteti i internetit

Ndërsa disa vende e garantojnë neutralitetin e internetit në ligje, të tjerat nuk merren me këtë çështje në mënyrë të qartë. Aksesit në informacion has probleme të ndryshme në vende të ndryshme, qofshin këto pengesa gjeografike ose çmime të larta të internetit apo çështje të tjera që shkelin të drejtën për të marrë dhe shpërndarë informacion.

- ▶ Serbia garanton akses të lirë ndaj informacionit, për shpërndarjen e informacionit dhe të përdorimit të aplikacioneve dhe shërbimeve që përdoruesit preferojnë.
- ▶ Në Kosovë, Ligji për Komunikimet Elektronike siguron që rregullimi i aktiviteteve të komunikimit elektronik të bazohet në parimin e neutralitetit teknologjik pa ndonjë diskriminim të teknologjive specifike.
- ▶ Shumica e territorit të Bosnjes dhe Hercegovinës është me reliev malor, kështu që janë marrë masa të posaçme që edhe në zona rurale dhe të largëta të sigurohet internet. Gjysma e familjeve rurale kanë një kompjuter, ndërsa dy të tretat jetojnë në zona të mbuluara nga një rrjet i telefonave celular. Më shumë se 90% e të rinjve në zonat rurale dhe urbane përdorin kompjuterë dhe internet, por ky përdorim është akoma të paktën 3-4% më i lartë në zonat urbane.
- ▶ Interneti në Shqipëri është mjaft i shtrenjtë dhe nuk ka masa për të siguruar një shpejtësi interneti të pranueshme me çmime të pranueshme. Shpejtësia e Internetit në Shqipëri është e ulët (nga 1 Mbps deri në 8 Mbps në lidhjet në shtëpi) dhe çmimi varion nga 10 euro në muaj deri në 100 euro në muaj për shpejtësi më të larta.



Liria e medias

Liria e medias është e garantuar me ligj, por pavarësia e mediave në praktikë është problematike në të gjitha vendet pasi ka çështje që lidhen me regjistrimin e mediave, presionet mbi mediat janë të zakonshme veçanërisht në komunitetet më të vogla dhe gjithashtu ka sulme teknike dhe censura është e shpeshtë. Si rrjedhojë, liria e medias po bie më shumë në disa vende dhe më pak në disa të tjera, por rënia e përgjithshme është e dukshme në të gjithë vendet.

- ▶ Sulmet teknike kundër mediave online në Serbi janë mjaft të shpeshta. Sulmet përfshijnë: sulmet DDoS që bllokojnë shërbimin, hyrje të paautorizuara, ndryshime të paautorizuara të përmbajtjes, injeksion të programeve dëmtuese (viruse, malware), etj. Në shenjestër janë shpesh organizatat mediatike kritike ndaj veprimeve të qeverisë.
- ▶ Në Bosnje dhe Hercegovinë, mjedisi mediatik është thellësisht i polarizuar përgjatë linjave etnike, dhe presionet ndaj mediave vijnë kryesisht nga parti politike.
- ▶ Sipas Freedom House, ka ndërhyrje politike direkte dhe indirekte në median në Kosovë, dhe është pohuar se disa autoritete kanë penguar punën e gazetarëve në disa raste.
- ▶ Disa media online në Shqipëri pretendojnë se përmbajtja e tyre në internet po censurohet dhe hiqet edhe nga faqet e tyre në Facebook.



Siguria e gazetarëve

Gazetarët dhe aktorët e mediave shpesh janë shënjestra sulmesh në të gjitha vendet dhe auto-censura është e zakonshme. Disa aktorë të shtetit shpesh përdorin sulme verbale dhe njollasje të gazetarëve, ata rrallë sigurojnë ndonjë mbrojtje dhe hetimet e krimeve ndaj gazetarëve marrin shumë kohë.

- ▶ **Më shumë se 60% e gazetarëve të Kosovës** ndjehen të kërcënuar nga dhuna deri në një farë mase, **22%** e gazetarëve thonë se ndjehen të kërcënuar “plotësisht”, ndërsa vetëm **7%** e gazetarëve mendojnë se sistemi i drejtësisë do të trajtonte çështjen e tyre në mënyrën e duhur.
- ▶ **Në Bosnje dhe Hercegovinë** ndërmjet **2006** dhe **2015**, vetëm **15%** e **60** krimeve të regjistruara ndaj gazetarëve u përfunduan nga ana ligjore, pra, **proceset gjyqësore u finalizuan**.
- ▶ **Hetimet për kërcënime dhe krime** ndaj gazetarëve dhe ndaj aktorëve të rinj mediatik janë shumë të ngadalta edhe pse ka shumë raste të sulmeve ndaj gazetarëve në Serbi, siç janë kërcënimet dhe frikësimet. Shumë shpesh ato mbeten të pazgjidhura.
- ▶ **Gazetarët dhe punonjësit e mediave në Shqipëri** kanë parë presione të shumta që vijnë nga instancat më të larta të qeverisë. Shpesh ata përballen me kërcënime dhe janë viktime të sulmeve.



3. E DREJTA E TUBIMIT PAQËSOR DHE ORGANIZIMIT

Liria e tubimit është e garantuar në të gjitha vendet. Mund të kufizohet vetëm nëse është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik, moralit, të drejtave të tjerëve ose sigurisë. Rrjetet sociale shpesh janë vërtetuar të jenë një mjete që mbledhin njerëz për kauza të ndryshme dhe më së shumti faqet në Facebook të lëvizjeve të ndryshme ose organizatave të shoqërisë civile.



4. E DREJTA PËR JETË PRIVATE DHE FAMILJARE

E drejta e privatësisë nuk përmendet në mënyrë të qartë në kushtetutat e disa prej vendeve, përkundrazi shpesh përfshihet si pjesë e të drejtave të tjera. Por me ndryshimet e sjella nga teknologjitë e reja, shtetet tani po përpiqen të miratojnë korniza të reja ligjore për ta adresuar këtë të drejtë duke ndryshuar ligjet ekzistuese dhe duke i bërë ato në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe duke krijuar institucione të reja përkatëse. Në këtë proces, të gjitha vendet hasin sfida sidomos në drejtimin e përgjimit të komunikimeve dhe filmimit në video.

- ▶ Në Serbi, mbikëqyrja me video e hapësirave publike nga autoritetet shtetërore nuk është e rregulluar, por ka dispozita që rregullojnë përpunimin e të dhënave me anë të mbikëqyrjes me video.
- ▶ Ndryshimet e fundit të ligjit shqiptar për përgjimin dhe Kodit të Procedurës Penale krijojnë më shumë hapësirë për përgjimin e komunikimit.
- ▶ Në Bosnje dhe Hercegovinë, Agjencia e Mbrojtjes së të Dhënave Personale nuk ka mbështetje të mjaftueshme nga autoritetet dhe për këtë arsye ata që shkelin privatësinë nuk vuajnë asnjë pasojë dhe në përgjithësi mbrojtja e të dhënave të qytetarëve të Bosnjes mbetet shumë në pikëpyetje.
- ▶ Kosova themeloi Komisionerin për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve të Komunikimeve i cili bën një kontroll vjetor të ligjshmërisë së përgjimit të komunikimeve dhe raporton shkelje të mundshme të identifikuara..

